# AKT - THEMELIMI
# I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
# "S.AG" SH.P.K.

Personi që firmos më poshtë :

**SOKOL AGOVIKU** i biri i HAJROS , lindur ne TIRANE dhe banues ne TIRANE identifikuar me pasaporten Nr 0488512
ka hartuar si më poshtë vijon Aktin e Themelimit të një shoqerie me përgjegjësi të kufizuar të cilën ka vendosur ta themelojë :

Në mbështetje të ligjit nr. 7638 , datë 19. 11.1992 "Për shoqëritë tregtare", unë ortaku i vetëm **SOKOL AGOVIKU**, vendosa krijimin e Shoqërisë me Pergjëgjësi të Kufizuar **"S.AG" SH.P.K.** për të zhvilluar aktivitet privat me

OBJEKT TE VEPRIMTARISE SE SAJ :

Shoqëria do të ketë objekt të veprimtarisë së saj :
projektim ,ndertim dhe ekspertiza per fushat e meposhteme
-Godina banimi ,godina social kulturore e industriale tete gjitha kategorive ,punime e ndertime portuale ,shtrim e asfaltim rruge e sheshe ura , ujesjellsa , linja elektrike kanalizime te ujrave ,instalime e montime te koonstruksioneve e pajisjeve e makineri te ndryshme Studime urbanistike te pjeseshme e te plota Tregtimi dhe dhenia me qera te apartamenteve ,dyqaneve ,parkingjeve ,magazinave e shesheve e troje ndertimi
Aktivitete industriale ,prodhim e tregtim te artikujve te materialeve te ndertimit ushqimore industriale farmaceutike elektroshtepiake ,gaz natyror ,duhan e cigare ,pije alkolike e freskuse ,fruta perime ,artikuj bujqesore e blegtoral .material ndertimi ,pajisje e makineri ,automjete dhe pjese nderrimi per to si dhe cdo lloj artikulli tjeter me objekt shitblerje me shumice dhe pakice ne eksport dhe import ,hapje restorante kafeteri ,bare diskoteka ,hoteleri dhe ne vende turistike dhe tregtimin ne to te cdo lloj malli kambizem konsultim biznesi etj Hapje dhe zhvillim i aktivitetit edukative e aresimore per cerdhe ,kopeshte dhe shkolla private te te gjitha niveleve
Veprimtari transport mallrash dhe njerzish per brenda dhe jashte vendi si dhe zhvillimi i aktivitetit riparus per automjete te ndryshme nepermjet pikave te riparimit dhe serviseve Shoqeria ka te drejte te zhvilloj aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e vendit dhe jashte saj nepermjet filialeve qe mund te hapi

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100.000 (njëqind mije) lekë.

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe mbi 10 (dhjëtë) vjetë

Selia do të jetë ne TIRANE.

Administratori i shoqërisë do të jetë z.SOKOL AGOVIKU

Përfaqësimi ndaj të tretëve do të bëhet nga administratori i shoqërisë

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në Gjykaten e Rrethit .

Viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë dhe mbaron më 31 dhjetor 2001 .
Çdo vit tjetër financiar fillon më 1 janar dhë përfundon më 31 dhjetor.

Çdo gjë që do të kryhet parashikohet në statutin që do të depozitohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë .

Ky Akt - Themelimi është hartuar , më 04.03. 02. në katër kopje origjinale duke patur fuqi të barabartë ligjore.

**Ortaku i vetëm**
**i "S.AG" SH.P.K.**

SOKOL AGOVIKU

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**ZYRA E NOTERISË**
**T I R A N Ë**
**Nr.** 642 **Rep Nr.** 108 **Kol**

**V Ë R T E T I M**

Sot më datë 04.03.02, në Zyrën e Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht para meje ortaku i vetëm i

**Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**
**i "S.AG " SH.P.K.**
**SOKOL AGOVIKU**

i cili më deklaroi se *Akti i Themelimit* i mësipërm është sipas vullnetit të tij të lirë e të plotë dhe unë noteri duke e gjetur konform ligjit e vërtetoj atë .

**N O T E R E**

Dhimitër Qerri

# STATUT

# I SHOQERISE "S.AG" SHPK

**Neni 1**

Shoqeria S.AG shpk, eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe perfaqesohet nga Ortake i vetem i saj Sokol Agoviku qe eshte edhe Administrator i saj.

**Neni 2**

Shoqeria ka kete statut ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 qe rregullon poziten juridike te Ortakut te vetem me punonjesit, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per penen ne shoqeri.

**Neni 3**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte
Pro jektim , ndertim, dhe ekspertiza per fushat e meposhteme
-Godina banimi,godina social kulturore e industriale te te gjitha kategorive ,punime e ndertime portuale ,shtrim e asfaltim rruge e sheshe ura , ujesjellsa ,linja elektrike , kanalizime te ujrave, instalime hidro sanitare e ngrohje ventilim .Instalime elektrike. Telefoni. citofeni e televizive dhe instalime e montime te konstruksioneve e pajisjeve e makineri te ndryshme .Studime urbanistike te pjeseshme e te plota
Tregtimi e dhenie me qera te apartamenteve ,dyqaneve .parkinge, magazina, sheshe e troje ndertimi
Aktivitetet industrial, prodhim e tregtim te artikujve te materialeve te ndertimit ushqimore industriale , farmaceutike elektroshtepiake, gaz natyror, duhan e cigare, pije alkolike e freskuese, fruta e perime, artikuj bujqesore e blegtorale, material ndertimi, pajisie, makineri, automjete dhe pjese nderrimi per to si dhe cdo lloj artikulli tjeter me objekt shitblerje me shumice dhe pakice ne eksport dhe import, hapje restorante, kafeteri, bare, diskoteka, hoteleri dhe ne vende turistike dhe tregetimin ne to te cdo lloj malli, kambizem, konsultim biznesi etj
-Hhhapje dhe zhvillim I aktivitetit educative e aresimore per cerdhe ,kopeshte dhe shkolla private te te gjithe niveleve

-Veprimtari transporti mallrash dhe njerzish per Brenda dhe jashte vendi ~~si dhe zhvillimi per Brenda dhe jashte vendi~~ si dhe zhvillim I aktivitetetit riparues per automjetet te ndryshme nepermjet pikave te riparimit dhe serviseve
Shoqeria ka te drejte per te zhvilluar aktivitetin e saj ne te gjithe qytetet e shqiperise dhe jashte saje nepermjet filialeve qe dote hapi
.Me vendim, te Ortakut te vetem dhe kerkese ne Gjykaten e rrethit Tirane, ky objekt veprimtarie mund te shtohet.

**Neni 4**

Selia e Shoqerise eshte ne Tirane, me adrese rruga Rruga Perlat Rexhepi, Pallati UNICOM, por ajo ka te drejte te cele dege, filiale apo perfaqesi ne te gjithe territorin Shqiptar apo edhe jashte tij.

**Neni 5**

Kapitali themelor i Shoqerise eshte ne shumen 100 000 leke, i ndare ne 100 kuota kapitali ku secila kuote perfaqeson shumen prej 1000 leke. Ky kapital eshte i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

Me vendim te Ortakut te vetem, ky kapital mund te shtohet apo te pakesohet. Po qe se pakesohet Ortaku i vetem duhet te marre masa per ndryshimin e formes se Shoqerise.

**Neni 6**

Pjesemarrja ne kapitalin themelor te shoqerise, nuk e pengon Ortakun e vetem te kete pavaresi ligjore, organizative dhe te drejta te tjera pronesie jashte Shoqerise.

Ortaku i vetem nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise tej kapialit tjemelor qe ka investuar per te. Po keshtu, Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e Ortakut te vetem si person fizik tej veprimtarise se Shoqerise.

**Neni 7**

Marrja ne pune ne Shoqeri behet me ane te kontratave te punes në të cilen pershkruhen te drejtat dhe detyrimet e paleve duke pasur parasysh ligjin per Marrdheniet e Punes.

**Neni 8**

Shoqeria percakton Fondin Themelor dhe Fondin Rezerve, por gjate veprimtarise se saj ajo mund te percaktoje edhe Fonde te tjera.

Fondi themelor i Shoqerise perdoret per kryerjen e veprimtarise se Shoqerise dhe perbehet nga mjetet e investuara nga Ortaku i vetem. Ai mund te perdoret dhe per te mbuluar rreziqet, por pas shfrytezimit te fondeve te tjera.

Perberja, shuma e pergjithshme dhe burimet per krijimin e Fondit dhe rezerva te fondeve te tjera, percaktohen nga Ortaku i vetem ne rolin e Drejtorit Ekzekutiv.

Detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise mbulohen nga Fondi Rezerve dhe nga fonde te tjera, ose nga shumat eventuale suplementare qe mund te derdhe Ortaku i vetem, ku keto detyrime nuk mund te mbulohen nga Fondet egzistuese.

**Neni 9**

Shoqeria, me vendim te Ortakut te vetem mund te pranoje edhe ortake te tjere duke ju shitur kuotat egzistuese te kapitalit te saj apo me kapital tjeter. Kuotat e ortakeve te tjere te futur ne Shoqeri shenohen ne librin e llogarise se Shoqerise.

**Neni 10**

Shoqeria eshte pronare per ato sende qe gezon kete te drejte, por edhe per sende te tjera ne perputhje me objektin e saj te veprimtarise. Ajo mund te bleje apo te shfrytezoje edhe te drejta te tjera materiale duke perfshire ketu edhe te drejten per te ofruar pasurite e veta.

**Neni 11**

Rrezikun e humbjeve ne afarizmin e Shoqerise e bart Ortaku i vetem ne perputhje me kapitalin themelor te investuar ne Shoqeri. Humbjet kompensohen nga e tere pasuria e Shoqerise.

**Neni 12**

Pasurite e Shoqerise vleresohen me bilancet e saj ne vlera te shprehura ne leke dhe ne perputhje me ligjin per Kontabilitetin. Forma e bilanceve dhe e llogarive ekonomike

- Percaktohen nga ortaku I vetem duke pasur parasysh parasysh dhe forman e bilanceve dhe llogarive ekonomike te subjekteve te tjera ne Shqiperi.
  Bilancet vjetore duhet te paraqiten brenda tremujorit te pare te vitit pasardhes.

Neni 13

Fitimi i realizuar nga shoqeria do te ndahet si me poshte .
80 % do te shkoje per rritjen e dhe zgjerimin e aktivitetit ose ne kapital .
5% do te shkoje per rezerva ligjore dhe 15 % do te shkoje per rezerva statutore ose te tjera per ndihme ose shperblime .

Neni 14

ORGANET DREJUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuese te shoqerise do te jene
1 Ortaku I vetem
2-Administratori
3-Komisioni I revizionit ose I eksperteve kontabel ..

Neni 14

Ortaku I vetem eshte oragni vendimor I shoqerise I cili percakton drejtimet kryesore te shoqerise, vendos per bilancet vjetore ,per shtimn ose pakesimin e kapitalit themelor , per pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, ben emerimin e administratorit vendos per pushimin e veprimtarise se shoqerise .

Neni 15

Administratori eshte organi ekzekutiv I shoqerise , ai miraton programet ekonomike emeron dhe shkarkon komisionin e revizionit dhe te eksperteve kontabel, ai çel leterkredi ne lek dhe ne valute te huaj depoziton nenshkrimin e tij ne Banke , lidh kontrata me punonjes [illegible] percakton numrin e punonjesve dhe pagat e tyre

Neni 16

Administratori ka te drejte te perfaqesoje shoqerine ne maredhenie me te tretet , vepron ne te gjithe sektoret e shoqerise per ndjekjen dhe realizimin e objektit te veprimtarise se shoqerise ,lidh, nenshkruan ndjek realizon kontratat e ndryshme, ben emerimin dhe pushimin e punonjesve te shoqerise , kur ata shkelin kontraten e ëunes ose veprimet e tyre , bien ndesh me interesat e shoqerise .

Neni 17

Ortaku I vetem ka te drejte te heqe dore nga roli I tij si administrator dhe mund te emeroje ne kete post persona te tjere jashte shoqerise , jo ortake te cileve u jep keto kompetenca qe percakton ky statut ose kompetenca te tjera .

NENI 18

Neni 18 Shoqeria pushon veprimtarine e saj ne cdo rast qe vendos ortaku I vetem , kur vendoset pushimi I veprimtarise se shoqerise ,ortaku I vetem emeron komisionin e likujdimit I cili paraqit bilancin e likujdimit

Shoqeria i jep fund veprimtarise se saj kur Ortaku i vetem miraton bilancin e likujdimit. Mjetet financiare te fituara, pasi shlyhen detyrimet ndaj kreditoreve, merren nga Ortaku i vetem i shoqerise se bashku me pjesen e kapitalit themelor te tij.

**Neni 19**

Ky statut u redaktua ne kater kopje nga te cilat nje kopje dorezohet ne zyren e Noterise Tirane, nje kopje ne Gjykaten e rrethit Tirane, nje kopje ne zyren e tatimeve dhe nje kopje ne dokumentacionin e shoqerise.

Ortaku i Vetem

Republika e Shqiperise
Dhoma e Noterise Tirane 643/10P.
Vertetim
Ne Tirane sot me dt. 04/03/02., ne zyren e Noterise Tirane, u paraqit Sokol Agoviku, e datelindjes 17/08/1973.,, banuese ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili deklaroi se ky eshte Statuti i Shoqerise "S. AG" shpk, i redaktuar me vullnetin e lire dhe i nenshkruar rregullisht.

Notere

PULLE TAKSE
R. SHQIPERISE

NOTERE
DHIMITRA
QARRI